



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 1850 prot.

Pukë më, 22.10.2024

VENDIM
Nr. 41 datë 16.10.2024.

PËR
“EMËRTIM RRUGE, NË TERRITORIN E BASHKISË PUKË”

Këshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e datës 16.10.2024, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 nënpika 1.7, shkronja “b”, neni 54 shkronja “ll”, neni 55 pika 2 e 6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar), nenit 2 pika 1(ç), neni 3, neni 5 pika 1, nenit 7, neni 25 e 26, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (i ndryshuar), Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar), si dhe në relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pas shqyrtimit dhe diskutimit të anetareve :

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e rrugës pranë sheshit qendror “Gjergj Kastrioti - Skenderbeu”, në drejtim të stacionit të autobuseve, me emrin rruga “Ndoc Mark Deda”, sipas planvendosjes bashkëlidhur
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Pukë
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”
4. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.

Vota te vlefshme gjithsej : 11

Vota pro 11, vota kunder 0, vota abstenim 0


SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA





Ruga Ndoc Mark Deda: Fillon ne "Pika-1 ne kryqezim me Rrugen "X" dhe Mbaron ne "Piken-2 kryqezim me Rrugen-Unaza"



07.11.24

seu | K J M V M T
Zev u Spelly U
Ullus



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

1850/4
07.11.2024
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.724/1prot.

Shkodër, më 04.11 2024

Lënda: Mbi Vendimin nr. 41, datë 16.10.2024 të Këshillit Bashkiak Puke.

KËSHILLIT BASHKIAK PUKE

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, neni 8, shkronja “a”, neni 56 i KPAD, Urdhërit të Kryeministrit nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1, nënpika 1.7, shkronja “b”, neni 54, shkronja “ll”, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja “c”, të ligjit Nr.9270, datë 29.07.2014 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, neni 3 dhe 6, Dokumentacionit dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Pukë, Nr.1896/3prot datë.22.10.2024, u njoh me VKB Pukë nr.41, datë 16.10.2024: “Mbi emërtimin e rrugës, (e cila ka qenë e paemërtuar), pranë sheshit “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu” në drejtim të stacionit të autobuzëve, me emërtimin rruga “Ndoc Mark Doda”. Ky akt nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative për te cilat Prefekti në zbatim te nenit 8, shkronja “a” e ligjit “Per Prefektin” i ndryshuar, ka detyrim të shprehet. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI

